

Më datë 28 Janar 2021, Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore në zbatim të urdhrin nr. 8 datë 18.01.2022 “Për kryerjen e analizës vjetore të veprimtarisë së Departamenteve të KLSH-së për vitin 2021”, ka zhvilluar në mjediset e *Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës* analizën vjetore të vitit 2021.

Pjesëmarrës në këtë analizë, përveç drejtuesve dhe audituesve të departamentit, ishin edhe Drejtori i Përgjithshëm znj. Marjola Llanaj, Sekretari i Përgjithshëm znj. Valbona Gaxha, z. Andon Kume Dekan i Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, si dhe përfaqësues të stafit akademik të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Analiza vjetore filloi me fjalën hyrëse të Drejtorit të Përgjithshëm znj. Marjola Llanaj, e cila falënderoj përfaqësuesit e stafit akademik të Universitetit për pranimin e ftesës për zhvillimin e analizës vjetore, duke theksuar se organizimi i analizave vjetore në mjediset universitare ka si qëllim bashkëpunimin e KLSH-së me trupat akademike, si një vlerë e shtuar për punën që kryen institucioni ynë. Në këtë frymë ka qenë edhe përzgjedhja e Universitetit të Durrësit për zhvillimin e një nga analizave të departamenteve, kjo edhe për faktin që qarku i Durrësit është një nga qarqet që përfshin disa institucione të rëndësishme që janë objekt auditimi i KLSH-së. Ndër të tjera znj. Llanaj vendosi theksin në objektivat dhe sfidat që e presin këtë departament në të ardhmen, në veçanti duke treguar një përkushtim dhe thellim profesional në punën audituese, si dhe në përmbushjen e objektivave dhe realizimin e auditimeve për vitin 2022 në frymën e një ekipi të vetëm, duke respektuar kornizën ligjore dhe standardet e auditimit.

Më pas fjalën e mori z. Andon Kume Dekan i Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, i cili falënderoi KLSH-në për ftesën që u mirëprit nga Universiteti për realizimin e analizës vjetore të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore. Gjithashtu ai shprehu angazhimin dhe dëshirën që ky bashkëpunim të vijojë dhe mos të ngelet vetëm në këto lloj aktivitetesh, por të shtrihet edhe në kërkime shkencore të përbashkëta, si dhe shprehu interesin se stafi akademik është i gatshëm për të qenë pjesë e konferencave që KLSH do të zhvillojë në të ardhmen, kjo edhe në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit që KLSH ka me Universiteti “Aleksandër Moisiu”.

Më pas u vijua me përmbledhjen e veprimtarisë audituese të Drejtoreshës së Departamentit znj. Yllka Pulashi, e cila u përqendrua fillimisht në statistikat vjetore për plotësimin e programit vjetor të auditimit, rezultatet e tyre të shprehura në rekomandime për përmirësime e ndryshime ligjore, masat organizative, administrative dhe disiplinore, masat për shpërblimin e dëmit së bashku me vlerën e tyre, rastet dhe numri i kallëzimeve/indicieve penale.

Gjithashtu u paraqit analiza e punës një vjeçare të Departamentit duke u analizuar bazuar në elementet e Analizës SWAT (fuqive/dobësitë/mundësitë/kërcënimet).

Gjithashtu gjatë analizës u pasqyruan edhe aktivitetet e tjera të departamentit, si pjesëmarrjet në trajnime, trajtimi i ankesave/kërkesave adresuar për trajtim nga Departamenti.



Analiza pati si qëllim dhënien e një panorame të përgjithshme të rezultateve, arritjeve kryesore në funksion të përmbushjes së objektivave të Departamenteve si dhe ato institucionale, por edhe në funksion të rritjes së figurës së audituesit dhe të besueshmërisë në kapacitetet dhe profesionalizmin e tij.

Aktiviteti vijoi me prezantimet e katër auditimeve të cilat u prezantuan nga audituesit: znj. Eni Kabashi për auditimin e kryer në subjektin Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; z. Alfonc Gabili për auditimin e kryer në subjektin “Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve”, z. Delor Prosi për auditimin e kryer në subjektin Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe znj. Joniada Goçaj për auditimin e kryer në subjektin Avokatura e Shtetit.



Në përfundim, drejtoresha e departamentit znj. Yllka Pulashi, prezantoi objektivat kryesorë të Departamentit për vitin 2022, duke mbajtur në fokus edhe objektivat afatmesme të institucionit bazuar në planin strategjik të zhvillimit vitet 2018-2022, ku ndër të tjera u ndal tek; Rritja e impaktit të punës audituese ; Auditimi mbi bazë risku – qasje efektive e auditimit ; Konsolidimi i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë; rritja e kapaciteteve audituese dhe profesionale; realizimi i punës audituese me cilësi dhe brenda afateve të përcaktuara; forcimi i marrëdhëniet me koleget duke rritur përpjekjet dhe gatishmërinë për të punuar dhe bashkëvepruar në grup etj.

Theksi u vu edhe në objektivat që kanë të bëjnë me rritjen e numrit të auditimeve financiare, auditimi i fondeve të akorduara për përballimin e pandemisë Covid-19, fondet për rindërtimin dhe monitorimin e kontratave koncesionare/PPP.

Gjithashtu, bashkëpunimi me universitetet, në veçanti me Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, i cili është një ndër universitete më të konsoliduar në sferën akademike, ishte një tjetër objektivi, i cili ka si qëllim zhvillimin e leksioneve të hapura me studentët për t’u dhënë mundësinë që të njihen më tepër me rolin dhe filozofinë e KLSH-së si mbikëqyrës i fondeve publike, dhe më specifikisht në auditimet e përputhshmërisë dhe ato financiare, Intership-eve për studentet e ekselencës, prezantimin dhe njohjen me auditimet me të mira dhe botimet e KLSH-së, të cilat mund të shërbejnë si një literaturë e shtuar për studentët dhe pse jo, edhe për stafin akademik.